

VENDIM
Nr.957, datë 21.9.2009

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DISA AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin porti i Durrësit- Qafë-Thanë, në datën 24 shtator 2009, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 6 (gjashtë) automjete dhe 68 (gjashtëdhjetë e tetë) trupa.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - porti i Durrësit, në datën 25 shtator 2009, të 5 (pesë) autokolonave ushtarake italiane, të përbëra si më poshtë vijon:

- Autokolona e parë, nga 14 (katërmëdhjetë) automjete dhe 16 (gjashtëmbëdhjetë) trupa;
- Autokolona e dytë, nga 13 (tremëdhjetë) automjete dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) trupa;
- Autokolona e tretë, nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjete dhe 36 (tridhjetë e gjashtë) trupa;

- Autokolona e katërt, nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjete dhe 45 (dyzet e pesë) trupa;
- Autokolona e pestë, nga 18 (tetëmbëdhjetë) automjete dhe 35 (tridhjetë e pesë) trupa.

3. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - porti i Durrësit, në datën 26 shtator 2009, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 15 (pesëmbëdhjetë) automjete dhe 35 (tridhjetë e pesë) trupa.

4. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin porti i Durrësit- Qafë-Thanë, në datën 29 shtator 2009, të 6 (gjashtë) autokolonave ushtarake italiane, të përbëra, si më poshtë vijon:

- Autokolona e parë, nga 11 (njëmbëdhjetë) automjete dhe 22 (njëzet e dy) trupa;
- Autokolona e dytë, nga 10 (dhjetë) automjete dhe 13 (tremëdhjetë) trupa;
- Autokolona e tretë, nga 20 (njëzet) automjete dhe 40 (dyzet) trupa;
- Autokolona e katërt, nga 19 (nëntëmbëdhjetë) automjete dhe 60 (gjashtëdhjetë) trupa;
- Autokolona e pestë, nga 19 (nëntëmbëdhjetë) automjete dhe 38 (tridhjetë e tetë) trupa;
- Autokolona e gjashtë, nga 9 (nëntë) automjete dhe 17 (shtatëmbëdhjetë) trupa.

5. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat, që do të kalojnë në datat 24 e 29 shtator 2009, është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

6. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat, që do të kalojnë në datat 25 e 26 shtator 2009, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit.

7. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha